



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Nr. 6179, Prot.

Tiranë, më 24.12.2024

URDHËR

Nr. 64, datë 24.12.2024

PËR

CAKTIMIN E ORARIT DITOR TË PUNËS, PËR ADMINISTRATËN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, kreu I, pika 2/b dhe kreu II, pika 2/b,

URDHËROJ:

1. Caktimin e orarit ditor të punës për nëpunësit civilë, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë, pjesë e administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili si rregull çdo ditë fillon në orën 08.00 dhe do përfundon në orën 16.30, ndërsa ditën e premte fillon në ora 08:00 dhe përfundon në orën 14.00.
2. Me zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe të gjithë nëpunësit civilë, nëpunësit dhe punonjësit e tjerë, pjesë e administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky urdhër hyn në fuqi me datë 01 janar 2025.

KRYETARI

ILIR RUSI

